




Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina

30-09-2015



**NJËSIA E PERSONELIT**  
Dt.29.09.2015

Në bazë të nenit 41 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores nr. 02/2010 për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil, si dhe duke iu referuar konkursit publik të rishpallur me dt. 19.08.2015, Njësia e personelit te Komunës së Prishtinës:

**N J O F T O N**

Se Komisioni përzgjedhës i shërbimit civil (KPSHC) gjatë shqyrtimit të aplikacioneve ka verifikuar se gjithsej 6 kandidatë i kanë plotësuar kushtet për t'i ftuar në testin me shkrim lidhur me pozitën-**Udhëheqës i Sektorit Ligjor**, në kuadër të **Kabinetit të Kryetarit**. Ndërsa, pas realizimit të testit me shkrim, dhe pas verifikimit të rezultatit nga ana e KPSHC-së, u konstatua se kandidatët e cekur si më poshtë nuk kanë rezultuar të suksesshëm, ngaqë në testin me shkrim nuk kanë arritur minimumin prej 50 % të pikëve të caktuara, konform nenit 36 paragrafi 2 të Rregullores nr. 02/2010 për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil dhe si kusht i domosdoshëm për t'u ftuar në intervistën me gojë.

- 1.Ardianë Ajeti - 0 pikë
- 2.Edita Krasniqi - 24 pikë
- 3.Fatmir Krasniqi - ka munguar ne testin me shkrim

KPSHC-së ka propozuar emërimin e këtij kandidati:

- 1.Ardian Olluri - 80 pikë

Propozimi nga KPSHC është miratuar nga Kryetari i Komunës, si udhëheqës më i lartë administrativ, pa ndonjë vërejtje.

Andaj, në përputhje me nenin 41 paragrafi 1 të Rregullores nr. 02/2012 për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil, akti i emërimit do të lëshohet brenda afatit prej 30 ditësh. Ndërkaq, sipas raportit përfundimtar të KPSHC, kandidatët tjerë të renditur si më poshtë, pas testit me shkrim dhe intervistës me gojë kanë arritur këto pikë:

- 1.Rukije Sheshivari - 67.5 pikë
- 2.Xhevdet Zani - 67.2pikë



Udhëheqësi i Personelit  
Avni Zuka